

Ngjitës për Parket

UZIN MK 92 S

Ngjitës 2-Komponentësh PUR për parket, pa tretës dhe pa ujë

Fushat e aplikimit:

Ngjitës 2-K Poliuretani sipas DIN EN 14293, për të gjitha llojet e parketit, special edhe për dru të ndjeshëm ndaj lagështisë dhe formatit, si dhe mbi Uzin-nënshtresat izo-luese për parket.

I përshtatshëm për të gjitha llojet e zakonshme të nënshtresave me fortësi dhe stabilitet të mjaftueshëm, p.sh. mbi estrihë çimentoje, -anhidridi apo -asfalti rrjedhës, kompensatë druri, Uzin-nënshtresa akustike të përshtatshme si dhe mbi ngrohje dyshemeje (sistem me ujë të ngrohtë).

Ngjitësit në bazë tretësi, sipas TRGS 610 çdoherë e më shumë kufizohen në përdorim, Ngjitësit disperziv, të cilët përmbajnë ujë, shpesh janë kushtimisht të përdorshëm, andaj: UZIN Ngjitësit Poliuretan - pa tretës dhe pa ujë, elastik dhe të shpejtë - një alternativë e sigurtë dhe ekonomike për çdo lloj të parketit dhe nënshtresës.

UZIN MK 92 S gjindet edhe në ngjyrë të kaftë të mbyllur, (kantë 10kg) special për dru të errëta, ato termike dhe dru ekzotike. Emërtimi UZIN MK 92 S dunkel.

Përparësitë/Vetitë e produktit:

Ngjitës pastoz 2 Komponentësh rrëshire reaksioni, përzihet nga Rrëshira A dhe forcuesi B, pa tretës dhe pa ujë, prandaj pa kurrfarë deformimi të parketit. Nuk i heq drurin lagështinë.



Masa lidhëse: Polyurethan nga Polyolen dhe Polyisocyanat (MDI).

- ▶ Pa ujë
- ▶ Shtrirje shumë e mirë
- ▶ Rruvije shumë e mirë
- ▶ Mbushës shumë i mirë
- ▶ I qëndrueshëm edhe në shtresëtrashësi të mëdha
- ▶ Lidhje shumë e shpejtë
- ▶ Deformueshmëri elastike
- ▶ Ngjitës parketi univerzal
- ▶ GISCODE RU 1/Pa tretës
- ▶ EMICODE EC 1 R/Emission shumë i varfër

Technische Daten:

Paketimi	
Kovë plastike:	A+B 10kg
Qëndrueshmëria:	minimum 12 muaj
Ngjyra:	bezhë
Temperatura e punës:	minimum 15°C mbi dysheme
Koha e hapur:	ca. 30 minuta*
Koha e punës:	ca. 40-60 minuta*
Grryerja/Lyerja me llak:	pas ca. 24 orësh*
Fortësia finale:	pas 3-5 ditësh*

*Në 20 °C dhe kushte normale për punë

UZIN MK 92 S

Përgatitja e nënshtresës:

Nënshtresa duhet të jetë e thatë, e fortë, pa çarje dhe substanca të cilat mund të ndikojnë negativisht në ngjitje. Të gjitha parregullsitë në nënshtresë duhet të sanohen. Estrihët e çimentos apo anhidritit duhet të gërryhen dhe me thithëse të përshtatshme të thithet pluhuri.

Tek shtruarja e parketit preferohet kontrollimi i veçantë i nënshtresës.

Nënshtresat absorbuese (të thithshme) dhe poroze lyeni me Astar 1-K PUR UZIN PE 414 Turbo, apo Astar 2-K Epoksireaktiv UZIN PE 420 apo Astar Epoksimbyllës 2-K UZIN PE 460/ UZIN PE 480. Përmbajuni kohës së tharjes.

Nënshtresat jo të rrafshëta apo shumë të vrazhda lyeni me Astar (prajmer) univerzal UZIN PE 360 dhe pastaj nivelizoni me Masë rrafshuese për parket NC 175 së paku 3 mm trashësi apo me masë rrafshuese të shpejtë NC 172 BiTurbo së paku 2mm trashësi, për të arritur një rrafshësi të lartë sipas rregullave të prodhuesit.

Respektoni shenimet teknike të produkteve tjera që përdoren gjatë punës.

Udhëzime për punë:

1. Para përdorimit ngjitësin vendoseni në temperaturë të dhomës. Rrëshirën dhe Forcuesin (A dhe B) përzieni mirë, kujdes të veçantë duhet të keni në fundin dhe muret e kantës pasi që ngjitësi jo mirë i përzier nuk thahet.
2. Ngjitësin e përzier homogjen shpërndajeni me lopatëz të dhëmbëzuar të mënyrë të barabartë mbi nënshtresë. Shpëndani vetëm aq ngjitës sa mund të përdorni brenda 50-60 minutash.
3. Elementet e parketit vendosini mbi ngjitës dhe shtypni apo rrotulloni mbi to me rul (rolle metali). Parketi duhet të ketë kontakt me ngjitësin në gjithë sipërfaqen e shpinës.
4. Ndërmjet dyshemesë së drurit dhe murit leni një distancë 10-15 mm duke përdorur pyka. Pykat i largoni pas përfundimit të punës.
5. **Vërejtje:** Gjurmët e ngjitësit pastroni menjëherë. Veglat e punës pastroni me tretës. Ngjitësi i tharë mund të hiqet vetëm në mënyrë mekanike.

Shpenzimi:

Lloji i parketit	Dhëmbëzori	Shpenzimi
Parket-masiv 10mm, i llamelluar, shumëstresor, industrial etj.	B11	1000-1200 gr/m ²
Parket mozaik 8mm	B3	800-1000 gr/m ²

Të dhëna të rëndësishme:

- Koha e deponimit të mallit është së paku 12 muaj në vend të thatë dhe të ftohtë në temperaturë mbi +5°C. Ambalazhën e nisur mbylleni mirë dhe me kujdes dhe sa më parë përdoreni atë. Para përdorimit ngjitësin vendoseni në temperaturë të dhomës.
- Kushtet optimale për punë janë në temperaturë nga +18°C deri +25°C dhe temperatura e nënshtresës mbi +15°C. Temperatura e lartë dhe lagështia e ultë relative e ajrit shkurtojnë, deri sa temperatura e ultë dhe lagështia e lartë në ajër zgjasin kohën e tharjes dhe dobësojnë ngjitjen.
- Para instalimit dyshemeja duhet të ketë elasticitet të përshtatshëm, të jetë aklimatizuar në kushte në të cilat do të përdoret.
- Për pastrimin e njollave të freskëta të ngjitësit dhe veglave të punës përdoreni ujë.
- Gjatë punës ju lutemi respektoni rregullat DIN 18365 „Shtruarja e dyshemeve“ dhe udhëzimet teknike për përdorimin e prodhimeve të UZIN-it.

Mbrojtja gjatë punës dhe mbrojtja e ambientit:

Ngjitësi përmban një sasi shumë të vogël të tretësit organik e cila nuk i tejkalon kufijtë e përcaktuar sipas masave VbF dhe sipas saj nuk ka nevojë për kurrfarë mase sigurie dhe shenja sipas rregullave normative.

Preferohet përdorimi i kremit mbrojtës për duar dhe ajrosja e lokalit të punës.

Hudhja e mbeturinave:

Aty ku është e mundur, mbeturinat e prodhimit mblidhni dhe përdorni përsëri. Mbetjet e papërdorura të prodhimit mos i hudhni në kanalizim, rrjedha ujore apo deponi ilegale. Pritni deri sa të thahen, pastaj depononi në mënyrë ligjore. Ambalazhën e mbetur hudhni sipas rregullores në fuqi.